

Fletëpalosje për kujdestarët në çështjet e kujdesjës

1. Gjeneralitetet

Duke marrë përsipër kujdesin, Ju përmbushni një detyrim të rëndësishëm si shtetasë. Ju merrni një pozicion vullnetar, të cilin duhet ta drejtoni me ndërgjegje dhe përgjegjësi ekskluzivisht në interes të personit për të cilin duhet të kujdeset.

Dispozitat ligjore për kujdesin janë të përfshira në §§ 1882 - 1888 të ligjit *Bürgerliches Gesetzbuch* (BGB).

Sipas § 1888 BGB janë në përdorim rregullore të shumta të zbatueshme për kujdesin (§§ 1821; 1823 - 1824; 1826; 1835 - 1862; 1864 - 1867; 1870 - 1874; 1875 I; 1876 I; 1877 - 1881 BGB). Rekomandohet të njiheni me këto rregullore.

Gjykata mbikëqyrëse e mbikëqyr punën Tuaj, ju këshillon për të gjitha pyetjet që lidhen me punën tuaj.

Ju duhet t'i jepni gjykatës mbikëqyrëse informacione rreth menaxhimit të punës Tuaj në çdo kohë sipas kërkesës.

Ju jeni përgjegjës për dëmin që vjen nga një shkelje e fajshme e detyrës ndaj personit për të cilin duhet të kujdeset; veçanërisht nëse kundër detyrimit nuk bëni kërkesa të personit për të cilin duhet të kujdeset. Ju mund të merrni sigurim kundër këtij rreziku. Ju mund të mësoni më shumë në gjykatën mbikëqyrëse.

Paratë e personit për të cilin duhet të kujdeset duhet të investohen, nëse nuk janë për tu mbajtur në dispozicion për shpenzimet aktuale. Konsiderimi kryesor është investimi në një llogari të bllokuar në një institucion krediti. Gjykata mbikëqyrëse mund tju lejojë të bëni një investim të ndryshme sipas § 1848 BGB.

2. Vetëm për kujdesitë në mungesë

Ju në kufitë të caktuar nga Gjykata mbikëqyrëse duhet të kujdeseni për çështjet rreth pasurisë të personit në mungesë dhe keni të drejtën e zavendësimit të personit në mungesë, për sa i përket rrethit të detyrave Tuaja.

3. Përfundimi i kujdesisë

Puna Juaj përfundon

a) me heqjen e kujdesisë nga Gjykata mbikëqyrëse,

b) nëse është një kujdesi për kryerjen e disa çështjeve individuale me kryerjen e tyre,

c) nëse është një kujdesi për një person që mungon me fuqin ligjore të vendimit për deklarimin e vdekjes ose përcaktimin e kohës së vdekjes.